



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:124361

Datë: 31.05.2021

Numri i dokumentit: 01831645

Ae.nr.97/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Liridon Maloku dhe Rrustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të sigurimit “[L...]” LLC, e regjistruar në ARBK, me nr....., të cilin me autorizim e përfaqëson “[A.L]”, avokat nga Prishtina, kundër kundërshtareve të sigurimit N.N.E “[N...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK, me nr....., dhe “[N2...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK me nr....., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit, nga Shoqëria e avokateve “[S.P]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, lidhur me caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së kundërshtareve të sigurimit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr.467/20, të datës 25.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me 07.05.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundërshtareve të masës së sigurimit N.N.E “[N...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK, me nr....., dhe “[N2...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK me nr....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr.467/20, të datës 25.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar në piken I të dispozitivit të aktgjykimit e ka miratuar pjesërisht si të bazuar propozimin e propozuesit “[L...]” LLC, e regjistruar në ARBK, me nr....., për caktimin e masës së sigurimit mbi palujtshmerine e kundërshtarëve të sigurimit N.N.E “[N...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK, me nr....., dhe Ndërmarrja “[N2...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK me nr....., ashtu që i ndalohe kundërshtareve të sigurimit apo ndonjë palë të tretë që ti tjetërsoje me anë të ndonjë veprimi juridike të shitblerjes, dhurimit, dhënies me qira, apo shfrytëzimit tjetër,

fshehë, ngarkoje me hipoteke, servitut apo çfarëdo ngarkese, barrë sendore apo barrë personale në dobi të personave të tretë dhe atë për:

- Banesën me nr..... në “[N...]” Lam.B.Kat.10 me sipërfaqe prej 93.08 m2 në vlerë prej 103,378.00€, sipas kontratës së nënshkruar me datën 20.05.2016.
- Vend parkingun “[G...]” nr..... në “[N...]” Llam.B në vlerë prej 13,200.00€ sipas kontratës së nënshkruar me datën 31.12.2016, dhe
- Banesën me kompensim nr..... në sipërfaqe prej 74.81m2 në vlerë prej 83,650.00€ sipas kontratës së lidhur me datën 06.12.2017.

Ndërsa ka refuzuar pjesërisht si të pa bazuar propozimin e propozuesit “[L...]”LLC, e regjistruar në ARBK, me nr....., për caktimin e masës së sigurimit mbi palujtshmerine e kundërshtarëve të sigurimit N.N.E “[N...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK, me nr....., dhe Ndërmarrja “[N2...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK me nr..... që ti ndalohet kundërshtarëve të sigurimit apo ndonjë palë të tretë që ti tjetërsoje me anë të ndonjë veprimi juridike të shitblerjes, dhurimit, dhënies me qira, apo shfrytëzimit tjetër, fshehë, ngarkoje me hipoteke, servitut apo çfarëdo ngarkese, barrë sendore apo barrë personale në dobi të personave të tretë dhe atë në tërë objektin “[N...]” me seli në Prishtinë, si dhe bllokimin i llogarive bankare të kundërshtarëve të sigurimit N.N.E “[N...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK, me nr....., dhe Ndërmarrja “[N2...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK me nr..... Në piken II të dispozitivit është obliguar Zyra Kadastrale në Komunën e Prishtinës që caktimin e kësaj masë të sigurisë, gjegjësisht vendosjen e kësaj mase të sigurisë si në piken I të dispozitivit në banesën me nr..... në “[N...]” Lam.B.kat.10 me sipërfaqe prej 93.08m2 në vlerë prej 103,378.00€ sipas kontratës së nënshkruar me datën 20.05.2016, banesën me kompensim nr..... në sipërfaqe prej 74.81m2 në vlerë prej 83.650.00€ sipas kontratës së lidhur me datën 06.12.2017 si dhe vend parkingun “[G...]”, nr.... në “[N...]” Llam.b në vlerën prej 13,200.00€ sipas kontratës së lidhur me datën 31.12.2016, ti rregulloje si dhe ti evidentojë në regjistrat përkatës të tyre. Dhe në piken III të dispozitivit është obliguar shërbimi Noteriale Oda e Noterëve të Kosovës, me seli në Prishtinë, që lidhur me caktimin e kësaj masë të sigurisë, gjegjësisht vendosjen e kësaj masë sigurie si në paragrafin I të këtij dispozitivit ta evidentojë në regjistrat përkatëse të tyre noteriale. Në piken IV të dispozitivit ka vendosur që kjo mase siguroese mbetet në fuqi deri në vendimin e ardhshëm gjyqësorë me të cilin do të ndryshohet apo hiqet ko masë siguroese. Dhe në piken V të dispozitivit ka vendosur që nga një kopje e këtij aktvendimi ti dorëzohet palëve, Zyrës kadastrale në Komunën e Prishtinës, si dhe Odes së Noterëve të Kosovës me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kan paraqitur ankesë kundërshtaret e sigurimit N.N.E “[N...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe “[N2...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave te procedurës kontestimore, dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Apelit ta aprovoje ankesën e kundërshtarëve të sigurimit dhe të ndryshohet aktvendimi IV.EK.C.nr.467/20, të datës 25.02.2021 ashtu që refuzohet në tërësi propozimi për caktimin e masës së sigurimit për shkak se me asnjë provë nuk është bërë e

besueshme kërkesa dhe nuk ekziston asnjë rrezik që kundërshtaret e sigurimit të ndikojnë negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Përgjigje ne ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhe se propozuesi i masës së sigurimit “[L...]” LLC, e regjistruar në ARBK, me nr., me seli në Prishtinë, me datën 30.09.2020 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, kundër kundërshtareve të sigurimit N.N.E “[N...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK, me nr....., dhe Ndërmarrja “[N2...]” sh.p.k., me seli në Prishtinë, e regjistruar në ARBK me nr....., nder të tjera ne padi/ propozimin për caktimin e masës së sigurimit ka theksuar se paditësi propozuesi ka kërkuar që personalisht të përmbush kontratën, për aq sa ka punuar sipas kontratës me sasi dhe cilësi në shumën prej 333,738.32€, mirëpo të paditura dëshirojnë që të fitojnë në kohë duke kërkuar që te shiten investimet tona me mashtrim dhe banesat të vërtetuara me para kontratës, duke kërkuar nga gjykata ta aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të caktohet masa e sigurisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së të sigurimit, me aktvendimin e atakuar, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e apelit e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.*

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besueshme faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi i sigurimit në këtë fazë të procedurës, ka

ofruar prova lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tij, me të cilat vërtetohen pretendimet e tij lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Po ashtu në rastin konkret plotësohet edhe kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurimit sepse propozuesi i masës së sigurimit ka ofruar prova të mjaftueshme se pa caktimin e masës së sigurisë pala kundërshtarë do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ka gjetur se propozimi është i bazuar, ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikueshme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata i vlerësoi pretendimet ankimore të kundërshtarëve të sigurimit por gjeti se të njëjtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.97/2021, dt.07.05.2021**

**KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.**